

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pagat e magistratëve/ Katër shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve: Ligjin do ta çojmë në Gjykatë Kushtetuese Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/pagat-e-magjistrateve-kater-shoqatat-e-gjyqtareve-dhe-pr-okuroreve-ligjin-do-ta-cojme-ne-gjykate-kushtetuese/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 14:34:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 14:25:17 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c8b1dd348505a88cd22f925352ed2c4dc50f813e0c8cfab6b405234c172455a1
TEKSTI	0b97df7597c32fc14e26429fe3d03931222eafb8a15fe32a71eeb4c256d249fb
PAMJA	0165d4cd7e1c2e728dfc4a279486592e55eb8bb3793b418527be5b28d4506aa3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6c7638237074973d6cfa89c278452649c73eeb34a07b6f02fe45733e0c65c861
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	565145c81569d96b39079f1db9ed9e378c0d0ec132a26687d139f465bf7be21b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6c7638237074973d6cfa89c278452649c73eeb34a07b6f02fe45733e0c65c861>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Aktualitet

Pagat e magistratëve/ Katër shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve: Ligjin do ta çojmë në Gjykatë Kushtetuese



Edi Hallaci

18 Shtator 2026



Shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve paralajmërojnë se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese kundër ndryshimeve ligjore për pagat e magistratëve, të miratuara nga Kuvendi në orët pas mesnate.

Në një qëndrim të përbashkët, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve, Shoqata e Prokurorëve dhe Forumi i Grave Gjyqtare bëjnë të ditur se do të kërkojnë pezullimin e zbatimit të ligjit, shfuqizimin e tij si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe shqyrtimin me përparësi të çështjes.

Në deklaratë shkruhet:

Me keqardhje kemi ndjekur procedurën parlamentare për miratimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë'". Që në fillim, kjo procedurë është karakterizuar, në vlerësimin tonë, nga shkelje të kërkesave kushtetuese, duke nisur nga miratimi i projektligjit përtej afatit kushtetues, mungesa e një analize financiare nga Këshilli i Ministrave, mungesa e konsultimit efektiv dhe dëgjimi tërësisht formal i grupeve të interesit dhe, në fund, hyrja e menjëhershme në fuqi e ligjit.

Shoqatat tona mbeten të palëkundura në qëndrimin e tyre për rivendosjen e të drejtave kushtetuese të magistratëve, të cilat janë cenuar haptazi nga ligji i miratuar në orët e mesnatës. Në këtë kuadër, informojmë opinionin publik se, me të njëjtën urgjencë me të cilën ky projektligj u shqyrtua, u miratua dhe u dekretua, do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar pezullimin e zbatimit të ligjit, shfuqizimin e tij si të papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe shqyrtimin e çështjes me përparësi.

Kjo kërkesë bëhet e domosdoshme pasi, përmes këtij ligji, cenohet jo vetëm statusi financiar i magjistratëve, i cili është i lidhur ngushtësisht me garantimin e pavarësisë së tyre, por edhe vetë themelet e shtetit të së drejtës, për shkak të mosrespektimit të hapur të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese.

Shoqatat tona shprehin bindjen e plotë në integritetin e procesit kushtetues dhe besimin se Gjykata Kushtetuese do të rivendosë standardet kushtetuese të cenuara. Kemi besimin e plotë se do të jetë pikërisht procesi kushtetues ai që do të sqarojë çështjet e ngritura dhe do të hedhë poshtë përpjekjet për të diskredituar magjistratët dhe kërkesat e tyre legjitime.

Theksojmë edhe një herë se kjo çështje nuk ka të bëjë me interesa financiare, siç është tentuar, në mënyrë të shtrembëruar, t'i paraqitet opinionit publik gjatë gjithë këtij procesi. Ajo lidhet me respektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, garantimin e pavarësisë së organeve të drejtësisë dhe mbrojtjen e themeleve të shtetit të së drejtës.

Për mbrojtjen e këtyre parimeve dhe vlerave kushtetuese, shoqatat tona mbeten të palëkundura dhe do të përdorin çdo mjet ligjor që Kushtetuta dhe ligji u vënë në dispozicion.



Pas miratimit në Kuvend, presidenti Begaj dekreton ligjin për pagat e magjistratëve!



Kuvendi miratoi me 84 vota pro formulën e re për pagat e magjistratëve!



Pagat e magjistratëve, rrëzohet kërkesa e PD-së për tërheqjen e draftit të PS-së!



PDK-ja çon në Kushtetuese konstituimin e Kuvendit të Kosovës!



Pagat e Drejtësisë, kryeministri Rama: Pavarësia ka rrëshqitur në papërgjegjshmëri!



Çfarë dihet për terapinë hiperbarike me oksigjen, po studiohet për kundër plakjes?



"E dashura jote duhet të shkojë me dikë tjetër"/ Avokat Ngjela zbulon kurën për ...



"Nuk mund ta lija jetim"/ Pse nuk u bë kurrë baba? Spartak Ngjela rrëfhet: Më mirë mos prano të bësh fëmijë, sesa...



Greta Kazazi zbulon si është sot raporti me Selin dhe planet për të ardhmen!



Papa Leon XIV paralajmëron për rrezikun e Inteligjencës Artificiale!



Të paguhesh për të lexuar, kjo po ndodh në Singapor!



Majko përlozet pas vendimit për ish-liderët e UÇK: Dramë njerëzore e jashtëzakonshme, mund të cenojë historinë!



Lorenc Hasrama: "Kam zgjedhur të jap më të mirën, festivalet..."



Nga Guardian te Reuters dhe Al Jazeera, çfarë shkruajnë mediat ndërkombëtare për vendimin e Gjykatës së Hagës për liderët e UÇK-së



Trupi gjykyes: Të katërt ish-anëtarët e UÇK-së penalisht përgjegjës për krime lufte




Çfarë dihet për terapinë hiperbarike me oksigjen, po studiohet për kundër plakjes?




Red Light Therapy, çfarë tregojnë studimet për terapinë me dritë të kuqe dhe përfitimet e saj?



Më shumë vite, më shumë shëndet: 7 zakone që mund t'i përfshini në jetën tuaj!



"Prej pesë vitesh duam një fëmijë..." / Çiljeta Xhilaga zbulon planet me Albanin: Kam menduar të bëj in vitro!



"Të kisha çerekun e egëve të kolegeve të mia..." / Çiljeta Xhilaga: Nuk kam vuajtur për vëmendje!



10 shenjat që tregojnë se ushqimi duhet të hidhet para se të...



Pjeshkat apo bananet?! Cili frut është më i mirë për sheqerin në gjak dhe kaliumin...



10 pjesët më të mira të mishit të vicit për proteina me pak yndyrë!



Pilula eksperimentale imiton hormonin që prodhohet gjatë aktivitetit fizik intensiv!



Çfarë nuk duhet të mungojë në dietën tuaj për flokë të shëndetshëm...

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

Kontaktimi
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for [tabnav widget](#) to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.